



Republika e Kosovës Republika Kosovo • Republic of Kosovo	Institucion i Avokatit të Popullit Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution
Nr./Br./No.	804/2022
Nr.i fq/Br.str./Nr.pg.	
Data/Datum/Date:	30/05/22
PRISHTINË-PRIŠTINA-PRISTINA	



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo**  
**Institucion i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution**

Prishtinë, më 30 maj 2022

Znj. Albina Shabani Rama, kryetare  
Gjykata Themelore në Prishtinë  
Pallati i Drejtësisë, Hajvali  
10000 Prishtinë

### LETËR REKOMANDIMI

Ankesa Nr.230/2021

Emin Cakiqi  
kundër

**Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Gllogovc**

E nderuara znj. Shabani Rama,

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 21 prill 2021 kishte pranuar ankesën e z. Emin Cakiqit (ankuesi) përkitazi me zvarritjen e procedurës gjyqësore lidhur me lëndën e tij C.nr.623/2020 parashtruar kundër Gjykatës Themelore në Prishtinë (GjThP) – Dega në Gllogovc lidhur me kompenzim dëmi.

Sipas shkresave të lëndës dhe pohimeve të ankuesit, më 22 maj 2020, lidhur me rastin e tij ankuesi kishte parashtruar padi për kompensim dëmi në vlerën prej 10.000.00 € (dhjetë mijë eurosh). Tute ai kishte thënë se për shkak të mosbatimit të vendimit të Drejtorisë Komunale të Arsimit në Gllogovc (Nr.09-610/01-58205, datë 4/10/2019) si dhe të rekomandimeve të Inspektoratit të Arsimit të datës 5.3.2020, të cilët ia kishin njohur të drejtën përfshirje në çerdhe, fëmijës së tij, vazhdonte të pësonte dëme materiale, meqenëse fëmijën e tij duhej ta regjistronte në një kopsht privat ku shpenzimet mujore arrinin 150 euro, përfshirë edhe 15 euro pagesë për psikologun që duhej ta siguronte një herë në javë, meqë fëmija i tij është me aftësi të kufizuar. Një situatë e tillë e ka vështirësuar gjendjen materiale dhe emocionale të paditësit si dhe të fëmijës me aftësi të kufizuar duke e cënuar mirëqenien e tij. Më tej ankuesi kishte thënë se deri më tanë gjykata nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim për ta proceduar rastin e tij.

Më 30 prill 2021, më 7 maj 2021 dhe më 19 maj 2021, përfaqësuesi i Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) kishte biseduar me ankuesin për disa informata dhe sqarime shtesë lidhur me rastin.

Më 10 qershor 2021, Avokati i Popullit nëpërmjet një shkrese kishte kërkuar informata nga ushtruesi i detyrës së kryetarit të GjThP-së për fazën në të cilën ndodhej procedura në çështjen e ankuesit dhe për veprimet që janë ndërmarrë apo që planifikoheshin të

ndërmerreshin nga gjykata, ashtu që ky rast të procedohej brenda afatit kohor, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj.

Më 22 qershor 2021, Avokati i Popullit nëpërmjet një shkresë nga GjThP-ja ishte njoftuar pos të tjerash: “*Të dhënrat e ofruara nga ana e juaj si numri i lëndës, palët procedurale si dhe Dega e Gjykatës nuk përputhen me të dhënrat e siguruara nga sistemi SMIL.*”

Më 6 korrik 2021, përfaqësuesi i IAP-së kishte kontaktuar me përfaqësuesin e Degës në Gllogoc të GjThP-së, për disa informata dhe sqarime shtesë lidhur me rastin, me ç’ rast kishte kërkuar informata edhe për fazën në të cilën ndodhet procedura në çështjen e ankuesit dhe për veprimet që janë ndërmarrë apo që planifikohen të ndërmerreshin nga gjykata, ashtu që ky rast të procedohej brenda afatit kohor, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj.

Më 6 korrik 2021, përfaqësuesi i Degës në Gllogoc të GjThP-së kishte informuar përfaqësuesin e IAP-së, pos të tjerash: “*Lënda nuk është në agjendën e Gjykatës për tu shqyrtaar për arsy se kjo lëndë është pranuar me dt. 05.06.2020, ndërsa jemi duke shqyrtaar lëndët sipas viteve 2015-2016, dhe vetëm lëndët me prioritet ligjor i shqyrtojmë jashtë planit të agjendës se Gjykatës për të cilën edhe ligji na jep të drejtë për të vendosur. Lëndën të cilën e ka kërkuar Paditësi nuk është me prioritet ligjor dhe e njëjta trajtohet sipas renditjes së numrit render të pranuar në këtë Gjykatë.*”

Më 12 korrik 2021, përfaqësuesi i IAP-së kishte informuar ankuesin lidhur me përgjigjen e gjykatës.

Më 28 shkurt 2022, përfaqësuesi i IAP-së është njoftuar nga ankuesi se deri më tanë gjykata nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për ta proceduar rastin e tij.

Më 1 mars 2022, përfaqësuesi i IAP-së sërisht ka kërkuar nga Dega në Gllogoc e GjThP-së informata për fazën në të cilën ndodhet procedura në çështjen e ankuesit dhe për veprimet që janë ndërmarrë apo që planifikohen të ndërmerren nga gjykata, ashtu që ky rast të procedohet brenda afatit kohor, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj.

Më 1 mars 2022, përfaqësuesi i Degës në Gllogoc të GjThP-së e ka informuar përfaqësuesin e IAP-së, pos të tjerash: “*Siqë ju kemi informuar më parë për lëndën se nuk është me prioritet ligjor dhe objekti i kontestit Kompensim e demit për te cilën kërkon paditësi nga e paditura dhe këto lende nuk janë te natyrës urgjente dhe është lende e vitit 2020, ndërsa tanë jemi duke kryer lendet e vitit 2016-2017 dhe ato me prioritet ligjore me te cilat lende kemi pune te përditshme.*”

Avokati i Popullit konsideron se lënda në fjalë duhet të trajtohet me prioritet duke qenë se ka të bëj me një grup të ndjeshëm të personave në këtë rast fëmijë me aftësi të kufizuara, në pajtim me obligimet kushtetuese dhe ligjore për mbrojtjen e fëmijës.

Së pari, Avokati i Popullit rikujton se Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si akti më i lartë ligjor, mbrojtës i drejtave të lirive themelore të njeriut, prandaj realizimi praktik i tyre është në interes të funksionimit të sundimit të ligjit.

Neni 31 i Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], paragrafi 1, përcakton: “*Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*”

Avokati i Popullit thekson se e drejta për mbrojtje gjyqësore të të drejtave është e garantuar me nenin 54 të Kushtetutës [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], ku përcaktohet: “*Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.*”

Avokati i Popullit vlerëson se është obligim kushtetues i shtetit që qytetarëve t'u garantojë që çështjet e tyre të dëgjohen drejtësisht, publikisht nga gjykata dhe brenda një afati të arsyeshëm, si dhe t'u garantojë mjete juridike efektive. Këto të drejta janë të garantuara me nenet 6 dhe 13 të KEDNj-së, të cilat përcaktojnë: “*Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme (...).*” (neni 6); dhe: “*Çdo njeri, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me këtë Konventë, ka të drejtë për mjetet ligjore efektive për rivendosjen e së drejtës nga një autoritet kombëtar (...).*” (neni 13). Pra kërkesat e nenit 13 mbështesin kërkesat e nenit 6 (shih aktgjykimin: *Kudla kundër Polonisë*).

Më tutje, Neni 50 [Të Drejtat e Fëmijës] obligon “*Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve*”. Ky parim i mishëruar edhe me Konventën për të Drejtat e Fëmijës e cila zbatohet drejtpërdrejtë në Kosovë [neni 20] si dhe në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës i cili në nenin 5, paragrafi 4 thekson se “*Për të siguruar interesin më të mirë të fëmijës duhet të respektohen parimet si në vijim: 4.3. vendimet administrative dhe gjyqësore që prekin fëmijën duhet të merren dhe zbatohen me shpejtësi dhe pa vonesa të paarsyeshme*”. Sipas Komitetit për të Drejtat e Fëmijës si autoriteti kryesor në interpretimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës në Komentin e Përgjithshëm nr.14, interesi më i mirë i fëmijës është koncept i trefishtë që përfshin: një të drejtë substanciale, parim ligjor intrepidues dhe rregull të procedurës. Si rregull i procedurës, sa herë që do të merret një vendim që do të ndikojë në një fëmijë të caktuar, një grup të identifikuar fëmijësh ose fëmijëve në përgjithësi, procesi i vendimmarrjes duhet të përfshijë një vlerësim të ndikimit të mundshëm (pozitiv ose negativ) të vendimit mbi fëmijën ose fëmijët në fjalë. Për më tepër, Neni 46 i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës shprehimisht parashevë mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuar ku të gjitha institucionet kanë për obligim “[...] që të eliminojnë të gjitha barrierrat infrastrukturore, sociale, mjedisore, institucionale dhe ligjore në fushat e arsimit, punësimit dhe arsimit profesional, kujdesit shëndetësor, rehabilitimit, aktivitatetve kulturore, argëtuese dhe sportive që fëmijët me aftësi të kufizuara të ushtrojnë të drejtat e parashikuara në këtë lig”.

Në këtë rast, vendimi i Gjykatës lidhur me rastin e kompenzimit të dëmit është tejet i rëndësishëm për të siguruar që fëmija me aftësi të kufizuara i paditësit, i cili është gjithashtu palë e dëmtuar në rast, do të ketë mundësi që me anë të këtij kompezimit të ketë qasje në shërbime arsimore dhe shëndetësore kualitative. Zvarritja e mëtutjeshme e lëndës do të kishte pasoja negative në mirëqenien e fëmijës dhe si e tillë nuk është në interesin më të mirë të fëmijës.

Avokati i Popullit vlerëson se nga përgjigjja e gjykatës shihet se pavarësisht se rasti është pranuar më 22 maj 2020, deri më tani nuk ka ndërmarrë asnjë veprim procedural për ta trajtuar atë.


Nisur nga ajo që u tha më lart, Avokati i Popullit vlerëson se në pajtim me Kushtetutën, Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës meqenëse kemi të bëjmë me një fëmijë me aftësi të kufizuara është në interesin më të mirë të fëmijës që rasti në fjalë të trajtohet me prioritet, prandaj Avokati i Popullit i

## REKOMANDON

Gjykatës Themelore në Prishtinë:

- *T'i ndërmarrë veprimet e nevojshme që pa vonesa të mëtutjeshme ta trajtojë rastin C.nr.623/20.*

Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.*”) dhe me nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit “(*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (...) duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*), ju lutemi mirësish të na informoni për veprimet që do t'i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

  
Me ndërime,

Naim Qelaj  
Avokat i Popullit